

General Terms and Conditions of Purchase Orders in Albania (GTCP-AL)

Version of March 31, 2025

1 Scope of application, order confirmation

1.1 These General Terms and Conditions of Purchase Orders (GTCP-AL) are applicable to all contracts (hereinafter also referred to as "Purchase Order") concluded by VERBUND AG and/or its group companies [except for Austrian Power Grid AG (APG) and Gas Connect Austria GmbH (GCA)] as principal (hereinafter "Principal", "PRIN" or "VERBUND") with a contractor (hereinafter "Contractor" or "CON"), unless Principal's order letter (SAP order) and its schedules provides otherwise.

1.2 These GTCP-AL apply on an exclusive basis. Even if no terms contrary to these GTCP-AL are incorporated in Contractor's terms and conditions, the latter will not become part of a contract without Principal's express written consent. These GTCP-AL are applicable also to all future business relationships, even if they were not specifically agreed again. Contractor shall confirm the Purchase Order in writing. Principal shall receive the order confirmation, validly signed by Contractor, within 14 calendar days of the date on which Contractor has received the Purchase Order. Otherwise, Principal reserves the right to revoke the Purchase Order without Contractor being entitled to any compensation.

2 Price, packaging, transportation and shipping

2.1 The agreed (total) price constitutes compensation for all supplies/services to be provided for the performance of the Purchase Order (the contract). It is a fixed net price for delivery to the place of performance/place of installation (DDP Incoterms 2020). Place of performance is the shipping address stated in the Purchase Order, unless otherwise agreed in writing. Partial deliveries are not admissible, unless otherwise agreed in writing. Cash on Delivery (COD) shipments require Principal's written consent. Contractor shall fulfill the obligations applicable to the packaging, labelling and transportation of hazardous goods and attach two copies of the safety data sheet to the shipment. Contractor shall procure at its own cost proper and appropriate packaging of all supplies and, in case of supplies of hazardous goods according to the Act on the Transport of Hazardous Goods (Law no. 118/2012, as amended), shall clean and decontaminate transport containers. Contractor shall properly dispose of packaging material in accordance with environmental regulations. Contractor shall demonstrate the type, quantity, origin, and whereabouts of any waste produced in connection with Contractor's activities to the satisfaction of Principal. Contractor shall be subject to these obligations even if Contractor is allowed to take back waste without a collection or treatment permit. Contractor is required to assume any financial burden which Principal incurs due to Contractor's failure to comply with provisions, including but not limited to shipping regulations.

Kushtet dhe afatet e përgjithshme të urdhrave të blerjes në Shqipëri (GTCP-AL)

Version of March 31, 2025

1 Fusha e zbatimit, konfirmimi i urdhrave

1.1 Këto Kushte dhe Afate të Përgjithshme të urdhrave të blerjes (GTCP-AL) i zbatohen ndaj të gjitha kontratave (në vijim quajtur edhe "Urdhër Blerje") të lidhura mes VERBUND AG dhe/ose shoqërive të tjera të grupit [me përjashtim të Austrian Power Grid AG (APG) dhe Gas Connect Austria GmbH (GCA)] duke vepruar si porositës (në vijim "Porositësi", "PRIN" ose "VERBUND") me një palë kontraktuese (në vijim "Kontraktuesi" ose "CON"), me përjashtim të rastin kur dokumenti i urdhrit të Porositësit (urdhri SAP) dhe shtojcat e tij parashikojnë ndryshe.

1.2 Këto GTCP-AL zbatohen në mënyrë ekskluzive. Edhe nëse kushtet dhe afatet e kontraktuesit nuk përmbajnë kushte që bien ndesh me këto GTCP-AL, ato (kushtet dhe afatet e kontraktuesit) nuk do të bëhen pjesë e një kontrate pa miratimin e shprehur me shkrim të Porositësit. Këto GTCP-AL i zbatohen gjithashtu të gjitha marrëdhënieve të ardhshme tregtare edhe nëse nuk do të pranohen përsëri në mënyrë të posaçme nga palët. Kontraktuesi do të konfirmojë Urdhrin e Blerjes me shkrim. Porositësi do të marrë konfirmimin e urdhrit, të nënshkruar rregullisht nga Kontraktuesi, brenda 14 ditësh kalendarike nga data në të cilën Kontraktuesi ka marrë Urdhrin e Blerjes. Përndryshe, Porositësi do të ketë të drejtë të revokojë Urdhrin e Blerjes dhe Kontraktuesi nuk do të ketë asnjë të drejtë kompensimi.

2 Çmimi, ambalazhimi, transporti dhe dërgimi

2.1 Çmimi (total) i rënë dakord përbën shpërbimin për të gjitha furnizimet/shërbimet që do të ofrohen në zbatim të Urdhrit të Blerjes (kontratës). Ky është një çmim i caktuar (fiks) neto për dorëzim në vendin e përbushjes/ e instalimit (DDP Incoterms 2020). Vendi i përbushjes është adresa e dorëzimit e përcaktuar në Urdhrin e Blerjes, me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe me shkrim. Dorëzimet e pjesshme nuk pranohen, me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe me shkrim. Dorëzimet kundrejt Pagesës (COD) duhet të miratohen me shkrim nga Porositësi. Kontraktuesi do të përbushë detyrimet e zbatueshme për ambalazhimin, etiketimin dhe transportin e mallrave të rrezikshme dhe t'i bashkëngjisë dërgesës dy kopje të fletës së të dhënave të sigurisë. Kontraktuesi do të sigurojë, me shpenzimet e veta, ambalazhimin e nevojshëm dhe të duhur të të gjitha mallrave, dhe, në rast mallrash të klasifikuara të rrezikshme sipas Aktit mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme (Ligji nr. 118/2012, i ndryshuar), do të pastrojë dhe do të dekontaminojë kontejnerët e transportit. Kontraktuesi do të asgjësojë siç duhet ambalazhet në përputhje me rregullat mjedisore. Kontraktuesi do të vërtetojë, në mënyrë të kënaqshme për Porositësin, llojin, sasinë, originën dhe vendndodhjen e të gjitha mbetjeve të krijuara nga aktiviteti i Kontraktuesit. Kontraktuesi do t'i nënshtrohet këtyre detyrimeve edhe nëse i lejohet të pranojë mbetjet pa ndonjë leje pranimi apo trajtimi. Kontraktuesi merr përsipër çdo pasojë financiare ndaj Porositësit, si pasojë e moszbatimit të këtyre rregullave nga Kontraktuesi, duke përfshirë por kufizim, rregullat e transportit.

2.2 Contractor undertakes to transfer and assign the above obligations also to any subcontractors or suppliers engaged by Contractor.

3 Penalties

3.1 If a penalty date set forth in the Purchase Order is exceeded, Principal is entitled to charge and to retain a penalty equal to 0.2 percent per calendar day of the exceeded time up to a maximum of 10 percent of the total sum, exclusive of value added tax (VAT), regardless of Contractor's fault and proof of damage.

3.2 The total sum consists of the original order value, as well as increases and reductions of the original order value.

3.3 The amount of damage and the recoverability of damage does not affect the amount of any penalties. This does not limit or exclude Principal's right to assert any damage in an amount which exceeds the amount of the penalties.

4 Correspondence, documents

Contractor shall exclusively address statements or notices (quoting the Purchase Order number) to Principal's "procurement" department. The Purchase Order number must be provided on all documents of Contractor. The supplies/services shall be accompanied by the necessary documents (delivery notes, packing lists, etc). In case of missing or incorrect documents (e.g. those missing the PO number), Principal is entitled to reject supplies/services and/or documents.

5 Documentation

Blueprints, operating regulations, lists of spare parts, any other documentation, data processing software or other instructions which are necessary or customary for the use or maintenance of supplies/services form a material part of the Purchase Order and shall be delivered to Principal or executed upon provision of a supply/service or upon completion, at the latest. Supplies/services shall be deemed to have been provided according to the terms of the contract and accepted by Principal only when Principal was able to examine these at the place where they are used and did not have any complaints.

6 Invoicing, assignment

6.1 Contractor shall send invoices to the address provided on the Purchase Order form (quoting the PO number). Invoices must be issued in verifiable form and meet the requirements of the applicable tax law, including value added tax law. Any documents necessary to verify an invoice shall be attached. Invoices shall be issued in the currency provided on the Purchase Order form. If the invoice currency is different than the Albanian Lekë, the invoice shall include the corresponding total invoice amount in Albanian Lekë, by applying the latest exchange rate published by the Bank of Albania with respect to the date of the invoice.

2.2 Kontraktuesi merr përsipër të transferojë dhe kalojë detyrimet si më sipër tek çdo nënkontraktues apo furnizues i angazhuar nga Kontraktuesi.

3 Penalitetet

3.1 Nëse tejkalohet një datë e parashikuar në Urdhrit e Blerjes për zbatimin e penaliteteve, Porositësi ka të drejtë të llogarisë dhe të zbatojë një penaltet të barabartë me 0.2 për qind të shumës totale për ditë kalendarike vonese, deri në një shumë maksimale të barabartë me 10 për qind të shumës totale, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), pavarësisht fajit të Kontraktuesit apo evidencës së dëmit.

3.2 Shuma totale përbëhet nga vlera origjinale e urdhrit, si dhe rritjet apo zvogëlimet që mund të bëhen mbi këtë vlerë origjinale.

3.3 Vlera e dëmit si dhe mundësia e rekuperimit të dëmit nuk ndikon mbi shumën e penaliteteve. Kjo nuk kufizon apo përjashton të drejtën e Porositësit për të pretenduar ndonjë dëm në një vlerë që e tejkalon vlerën e penaliteteve.

4 Korrespondenca, dokumentet

Kontraktuesi do t'ia drejtojë deklaratat ose njoftimet (duke përcaktuar numrin e Urdhrit të Blerjes) ekskluzivisht departamentit të "prokurimit" të Porositësit. Numri i Urdhrit të Blerjes duhet të përcaktohet në të gjitha dokumentet e Kontraktuesit. Furnizimet/shërbimet duhet të shoqërohen me dokumentet e nevojshme (fletë dorëzimi, listat e mallrave të dëguara, etj.). Në rast mangësie në dokumentacion apo të dokumentacioni të pasaktë (p.sh. dokumente ku nuk është përcaktuar numri i Urdhrit të Blerjes), Porositësi do të ketë të drejtë të refuzojë furnizimet/shërbimet dhe/ose dokumentet.

5 Dokumentacioni

Projektet, rregulloret e operimit, listat e pjesëve rezervë, çdo dokumentacion tjetër, *software*-t për përpunimin e të dhënave ose udhëzime të tjera që janë të nevojshme ose të zakonshme për përdorimin ose mirëmbajtjen e furnizimeve/shërbimeve, përbëjnë pjesë thelbësore të Urdhrit të Blerjes dhe do t'i dorëzohen Porositësit ose do të nënshkruhen pas ofrimit të një furnizimi/shërbimi ose, më së voni, pas përmbytjes. Furnizimet/shërbimet do të konsiderohen se janë ofruar sipas kushteve të kontratës, dhe se janë pranuar nga Porositësi, vetëm nëse ky i fundit ka qenë i aftë t'i ekzaminojë ato në vendin ku janë përdorur dhe nuk ka pasur asnjë ankesë.

6 Faturimi, cedimi

6.1 Kontraktuesi do t'i dërgojë faturat në adresën e dhënë në formularin e Urdhrit të Blerjes (duke përcaktuar numrin e Urdhrit të Blerjes). Faturat duhet të lëshohen në formë të verifikueshme dhe të plotësojnë kërkesat e ligjit tatimor të zbatueshëm, duke përfshirë ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar. Çdo dokument i nevojshëm për të verifikuar një faturë duhet t'i bashkëngjitet faturës. Faturat do të lëshohen në monedhën e përcaktuar në formularin e Urdhrit të Blerjes. Nëse monedha e faturës është e ndryshme nga Lekë shqiptar, fatura do të përfshijë shumën totale të faturës në lekë shqiptar, llogaritur me kursin më të fundit të këmbimit të botuar nga Banka e Shqipërisë në lidhje me datën e faturës.

6.2 Invoices may be issued by third parties or claims against Principal assigned only with Principal's prior written consent.

6.3 The term of payment according to Section 7.1 starts to run after the Principal has received an invoice which meets the requirements stipulated in this Section 6 (along with all documents necessary to verify such invoice).

7 Terms of payment, default interest

7.1 Invoices shall be paid in the currency provided on the Purchase Order form. Principal will pay invoices within 30 calendar days after receipt of an invoice, provided they were issued in accordance with the requirements stipulated in Section 6 and the supply/service is free of defects. The deadline for payment starts to run again with submission of the new/corrected invoice. Agreed discounts apply to each partial invoice. If a partial invoice is not paid within the time during which a discount applies, the discount for the relevant partial invoice is forfeited without effect for other invoices or discounts. Principal carries out bank transfers only once a week, on the payment date. The deadline for payment is extended accordingly on the three calendar days prior to that date or is reduced accordingly on the three calendar days after that date. The time at which Principal has instructed its bank to transfer the money is relevant for the timeliness of a payment. Principal is deemed to be in default only after Contractor has given prior notice.

7.2 If Contractor or Principal are in default of payment, default interest at the rate of the applicable 1-month EURIBOR, plus 400 base points p.a., is agreed.

8 Contractor's default, warranty

8.1 If Contractor is in default and does not meet a certain calendar date or fails to fulfill its contractual obligations despite a grace period granted, Principal - notwithstanding any claims for the compensation of damage - may, at its election either reject the previously provided (partial) supplies/services, in whole or in part, and request defect-free and complete performance, or request a reasonable price reduction or forthwith withdraw from the contract and procure substitute performance at Contractor's cost and risk.

8.2 Contractor fully warrants that Contractor's supplies/services possess the properties that were explicitly agreed in the Purchase Order and are normally expected in accordance with the codes of practice and the relevant legal provisions. Throughout the entire warranty period it is assumed that a defect has already existed when the supplies were made, or the services were provided. In addition, Contractor guarantees to rectify upon request those defects which occur within the guarantee period, either due to faults in the material, defective construction, defective production etc. Contractor waives the right to plead that noticeable defects of supplies/services were notified too late. Any costs and risks arising in connection with corrective action shall be borne by Contractor. Any corrective action shall be subject to the same warranty provisions that are applicable to the main supply/service.

6.2 Faturat mund të lëshohen nga palë të treta, dhe pretendimet e pagesës ndaj Porositësit mund t'i kalohen palëve të treta, vetëm me miratimin paraprak me shkrim nga Porositësi.

6.3 Afati i pagesës sipas Seksionit 7.1 fillon nga momenti pas të cilit Porositësi merr një faturë që përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë Seksion 6 (së bashku me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar faturën në fjalë).

7 Afatet e pagesës, kamatëvonesa

7.1 Faturat do të paguhen në monedhën e përcaktuar në formularin e Urdhrit të Blerjes. Porositësi do të paguajë faturat brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së një fature, me kusht që ato të jenë lëshuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Seksionin 6 dhe furnizimi/shërbimi të ketë qenë pa defekte. Afati i pagesës fillon sërisht me dorëzimin e faturës së re/korrigjuar. Zbritjet e rëna dakord i zbatohen çdo fature të pjesshme. Nëse një faturë e pjesshme nuk paguhet brenda periudhës gjatë së cilës zbatohet një zbritje, zbritja për faturën e pjesshme përkatëse anulohet, pa efekt mbi faturat ose zbritjet e tjera. Porositësi kryen transferta bankare vetëm një herë në javë, në datën e pagesës. Afati i pagesës zgjatet në përputhje me rrethanat, kur bie në tre ditët kalendarike përpara datës së pagesës, ose shkurtohet në përputhje me rrethanat, kur bie në tre ditët kalendarike pas datës së pagesës. Koha kur Porositësi ka udhëzuar bankën e saj për të transferuar paratë merret në konsideratë për përcaktimin e datës së pagesës. Porositësi do të jetë në vonesë vetëm pasi Kontraktuesi i ka njoftuar paraprakisht vënien në vonesë.

7.2 Nëse Kontraktuesi ose Porositësi janë në vonesë të pagesave, kamatëvonesa e zbatueshme do të jetë EURIBOR 1-mujor, plus 400 pikë bazë në vit.

8 Mospërmbushja e Kontraktuesit, garancia

8.1 Nëse Kontraktuesi është në mospërmbushje dhe nuk përmbush një detyrim brenda datës kalendarike të caktuar ose brenda afatit shtesë të lejuar (*grace period*), Porositësi – pa cenuar çdo pretendim tjetër për shpërbim dëmi - mundet, në zgjedhjen e tij, të refuzojë furnizimet/shërbimet (të pjesshme) të ofruara më parë, tërësisht ose pjesërisht, dhe të kërkojë zbatimin e plotë të kontratës pa defekte, ose të kërkojë një ulje të arsyeshme të çmimit, ose të tërhiqet menjëherë nga kontrata dhe të prokurojë përmbushje zëvendësuese, me rrezikun dhe kostot në ngarkim të Kontraktuesit.

8.2 Kontraktuesi garanton plotësisht se furnizimet/shërbimet e tij paraqesin karakteristikat e rëna shprehimisht dakord në Urdhër të Blerjes dhe se ato janë normalisht të pritshme në përputhje me kodet e praktikës dhe parashikimet ligjore përkatëse. Gjatë gjithë periudhës së garancisë do të supozohet se një defekt ka ekzistuar që kur janë bërë furnizimet ose janë ofruar shërbimet. Për më tepër, Kontraktuesi garanton se do të korrigjojë menjëherë pas kërkesës defektet që ndodhin brenda periudhës së garancisë, qoftë për shkak të defekteve në material, defekteve në ndërtim, defekteve në prodhim etj. Kontraktuesi heq dorë nga e drejta për të pretenduar se defektet e dukshme të furnizimeve/shërbimeve janë njoftuar shumë vonë. Çdo shpenzim dhe rrezik që lind në lidhje me veprime korrigjuese të Kontraktuesit do të përballohet nga ky i fundit. Çdo veprim korrigjues do t'i

The warranty and guarantee period for replaced parts starts to run again upon delivery. If Contractor fails to promptly take corrective action, Principal may rectify or procure the rectification of the defect at Contractor's cost and risk, notwithstanding Contractor's warranty/guarantee obligations.

8.3 The guarantee and warranty period is 36 months for movable goods and 24 months for works, unless a longer statutory warranty and guarantee period is applicable for the specific good/work/service. Claims for deformations or defects must be notified by the Principal within 60 days of their discovery. Exchanged parts are taken over by Contractor and are transferred to Contractor's property, unless Principal wants to use them otherwise. In case of waste, Sections 2.1 and 2.2 apply accordingly.

9 Liability, subcontractors, insurance

9.1 Contractor is liable for the performance of the supplies/services, free of defects, in accordance with the Purchase Order and the relevant provisions, standards etc. Contractor is liable in accordance with the legal provisions for any personal injury, property damage, and any other disadvantage which was incurred by Principal and caused by Contractor, the personnel engaged by him as well as any third parties engaged by him. In the absence of gross negligence and/or premeditation, claims will not be asserted for the compensation of damage which Principal incurs due to energy failures (generation or transmission). Any damage which Principal incurs (lack of generation and/or transmission) shall be calculated in such a manner that the energy which could have been generated and/or transmitted during a failure, had operation been optimal, is valued at market prices. Relief is granted only in events of force majeure. Events of force majeure are exclusively natural disasters, mobilization, war and riots.

9.2 Subcontractors and suppliers are vicarious agents of Contractor according to Article 619 of the Albanian Civil Code.

9.3 Contractor shall procure insurance cover appropriate to the scope of supplies/services (such as liability, assembly, transport insurance).

10 Service provision, conduct and rules at the workplace

10.1 In connection with the performance of the contract, Contractor is additionally obligated vis-à-vis Principal: (i) to comply with official reporting duties (e.g. according to the legislation on safety and health in the workplace); (ii) to meet the requirements of Albanian labour and social law; (iii) to ensure that employees hold the required qualifications and work/employment permits at the time in question (and to provide the relevant documentary evidence to Principal free of charge); (iv) to ensure that employees comply with applicable safety regulations (Contractor is required to draw employees' attention to

nënshtrohet po atyre parashikimeve të garancisë që janë të zbatueshme për furnizimin/shërbimin kryesor. Periudha e garancisë dhe e përputhshmërisë kontraktore për pjesët e zëvendësuara fillon të llogaritet sërish pas dorëzimit. Nëse Kontraktuesi nuk ndërmerr pa vonesa veprimet korrigjuese, Porositësi mund të korrigjojë ose të prokurojë korrigjimin e defektit me kostot dhe rrezikun e Kontraktuesit, pavarësisht nga detyrimet e Kontraktuesit mbi garancinë/përputhshmërinë.

8.3 Periudha e garancisë dhe e përputhshmërisë është 36 muaj për mallrat e luajtshme dhe 24 muaj për punimet, përveç rasteve kur një periudhë ligjore më e gjatë parashikohet për garancinë/përputhshmërinë për ndonjë mall/punë/shërbim specifik. Pretendimet për deformime ose defekte duhet të njoftohen nga Porositësi brenda 60 ditëve nga zbulimi i tyre. Pjesët e ndërruara merren përsipër nga Pala Kontraktuese dhe bëhen pronë e tij, përveçse kur Porositësi dëshiron t'i përdorë ato. Në rast se krijohen mbetje, zbatohen Seksionet 2.1 dhe 2.2.

9 Përgjegjësia, nën-kontraktuesit, sigurimi

9.1 Kontraktuesi është përgjegjës për kryerjen e furnizimeve/shërbimeve, pa defekte, në përputhje me Urdhrin e Blerjes dhe parashikimet përkatëse, standardet etj. Kontraktuesi është përgjegjës në përputhje me parashikimet ligjore për çdo dëmim personal, dëme të pronës dhe çdo dëm tjetër që i shkaktohet Porositësit nga Kontraktuesi, nga punëmarrësit e Kontraktuesit apo nga ndonjë palë e tretë e angazhuar nga Kontraktuesi. Me përjashtim të rastit kur ka neglizhencë të rëndë dhe/ose dashje, pretendimet për shpërbimin e dëmit që i shkaktohet Porositësit si pasojë e ndërprerjeve të energjisë (në prodhim ose transmetim) nuk do të ngrihen. Çdo dëm që i shkaktohet Porositësit (në rast ndërprerjeje të prodhimit dhe/ose transmetimit të energjisë) do të llogaritet me vlerën e tregut të energjisë, që do të mund të ishte prodhuar dhe/ose transmetuar gjatë periudhës së ndërprerjes, nëse do kishte pasur kushte optimale operimi. Lehtësimi nga përgjegjësia për dëmet lejohet vetëm në rast të forcës madhore. Ngjarjet e forcës madhore janë ekskluzivisht fatkeqësitë natyrore, mobilizimi, lufta dhe trazirat.

9.2 Kontraktuesi është përgjegjës për veprimet e nënkontraktuesve dhe furnitorëve të tij, në kuptim të nenit 619 të Kodit Civil Shqiptar.

9.3 Kontraktuesi do të prokurojë polica sigurimi të përshtatshme për rreziqet e lidhura me objektin e furnizimeve/shërbimeve të tij (si sigurimi i përgjegjësisë, montimit, transportit).

10 Ofrimi i shërbimeve, sjellja dhe rregullat e zbatueshme në vendin e punës

10.1 Në lidhje me zbatimin e kontratës, Kontraktuesi është gjithashtu i detyruar kundrejt Porositësit: (i) të zbatojë detyrimet e raportimit zyrtar (p.sh. sipas legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës); (ii) të përmbushë kërkesat e ligjit shqiptar të punës dhe të mbrojtjes sociale; (iii) të sigurojë që punonjësit të kenë kualifikimet e kërkuara dhe lejet e punës në kohën e duhur (dhe të vendosë në dispozicion Porositësit dokumentacionin e duhur, pa pagesë); (iv) të sigurojë që punonjësit të respektojnë rregulloret e sigurisë në fuqi (Kontraktuesi duhet të tërheqë vëmendjen e punonjësve

these special duties of care, confidentiality and secrecy according to the Data Protection Act and the consequences in case of infringement); (v) to provide sufficient and demonstrable information to employees on local safety provisions as well as hazards.

10.2 Besides the legal provisions and official regulations, Contractor shall adhere to and comply with the "Health, Safety and Environmental Protection Policy for the Provision of Services of Contractors on VERBUND Locations and/or Construction Sites in Albania", the most recent version thereof is available at www.verbund.com/procurement. When work commences on the site, Contractor's work supervisor shall document the acknowledgement of this policy and hand this record over to Principal's contact on site.

10.3 Contractor is responsible for the fulfilment of these obligations by its employees and subcontractors or their employees, shall monitor compliance, is liable for damage due to infringement and shall hold harmless and indemnify Principal in this respect.

11 Proprietary rights

11.1 Any documents and information (analyses, reports, expert opinions, organizational plans, specifications, sketches etc.) will remain Principal's exclusive property and may be used by Contractor only for the performance of the contract. These documents etc. shall be returned at the Principal's request.

11.2 The agreed (total) price covers the use and exploitation of intellectual property rights (e.g. copyrights, to patents, designs, trademarks and utility models) by Principal to the extent this is necessary for the free use of Contractor's supplies/services. Contractor is liable for the non-infringement of third-party property rights and holds harmless and indemnifies Principal in this respect. Contractor may not use the content of services/work/results provided for the advertising or as reference without Principal's prior consent.

12 Confidentiality and data privacy

12.1 Contractor undertakes to keep confidential and not to disclose any information and data, notices, documents, business and trade secrets, know-how, etc., disclosed, provided or made available in connection with the implementation of the contract either in written form, orally or via electronic data transfer or otherwise ("Confidential Information").

12.2 Contractor undertakes to use Confidential Information only to perform the contract and undertakes not to transfer Confidential Information as a whole, in part or in extracts, to third parties or to make it available in any other form to third parties. Furthermore, Contractor undertakes not to otherwise process or otherwise use and exploit Confidential Information, in particular not for its own purposes. Publications relating to the project, including photographs

ndaj këtyre detyrave të veçanta të kujdesit, konfidencialitetit dhe të ruajtjes së sekretit, sipas Aktit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe ndaj pasojave në rast shkeljeje); (v) t'i ofrojë punonjësve informacion të mjaftueshëm dhe ta provojë këtë, sipas parashikimeve lokale të sigurisë si dhe mbi rreziqet.

10.2 Përveç parashikimeve ligjore dhe rregullave të zbatueshme, Kontraktuesi duhet të pranojë dhe t'i përmbahet "Dokumentit për mbrojtjen e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit për Ofrimin e Shërbimeve të Palëve Kontraktuese në Vendndodhjet e VERBUND dhe/ose Shesheve të Ndërtimit në Shqipëri", versioni më i fundit i të cilit mund të konsultohet në www.verbund.com/procurement. Me fillimin e punës në kantier, mbikëqyrësi i punimeve të Kontraktuesit do të dokumentojë pranimin e këtij dokumenti dhe do t'ia dorëzojë dokumentin në fjalë përfaqësuesit të Porositësit në kantier.

10.3 Kontraktuesi është përgjegjëse për përmbushjen e këtyre detyrimeve nga punonjësit e tij dhe nënkontraktorët ose punonjësit e tyre, ai do të monitorojë zbatimin e këtyre detyrimeve, dhe është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushjet dhe do të dëmshpërblejë Porositësin për çdo dëm lidhur me sa më sipër.

11 Pronësia intelektuale

11.1 Çdo dokument dhe informacion (analiza, raporte, opinione ekspertësh, plane organizative, specifikime, skica etj.) do të mbetet pronë ekskluzive e Porositësit dhe mund të përdoret nga Kontraktuesi vetëm për zbatimin e kontratës. Këto dokumente etj. do t'i kthehen Porositësit me kërkesë të këtij të fundit.

11.2 Çmimi (total) i rënë dakord mbulon përdorimin dhe shfrytëzimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (p.sh. të drejtat e autorit, për patentat, dizajnët, markat tregtare dhe modelet e përdorimit) nga Porositësi në masën që kjo është e nevojshme për përdorimin e lirë të furnizimeve/shërbimeve të kryera nga Kontraktuesi. Kontraktuesi është përgjegjës për mos cenimin e të drejtave të palëve të treta dhe mbron dhe dëmshpërblen Porositësin për çdo dëm të lidhur me sa më sipër. Kontraktuesi nuk mund të përdorë përmbajtjen e shërbimeve/punës/rezultateve të ofruara për reklamë ose si referencë, pa pëlqimin paraprak të Porositësit.

12 Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave

12.1 Kontraktuesi merr përsipër të ruajë konfidencialitetin dhe të mos përhapë asnjë informacion dhe të dhënë, njoftim, dokument, sekret biznesi dhe tregtar, njohuri, etj., të zbuluar, të paraqitur ose të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës, qoftë në formë të shkruar, gojarisht ose nëpërmjet transferimit elektronik të të dhënave, ose në mënyra të ndryshe ("Informacioni Konfidencial").

12.2 Kontraktuesi merr përsipër të përdorë Informacionin Konfidencial vetëm për të përmbushur kontratën dhe të mos transferojë Informacionin Konfidencial në tërësi, pjesërisht ose në ekstrakte, tek palë të treta ose t'ia vërë atë në dispozicion palëve të treta, në çfarëdo forme tjetër. Për më tepër, Kontraktuesi merr përsipër të mos përpunojë, përdorë ose shfrytëzojë Informacionin Konfidencial, veçanërisht jo për qëllimet e veta. Publikimet në lidhje me projektin, duke përfshirë fotografitë e çdo lloji, si dhe çdo

of any kind, as well as any advertising on the construction site is permitted only with Principal's consent.

12.3 Contractor shall take adequate precautions to prevent any unauthorized use of Confidential Information and/or to avoid any access to Confidential Information by third parties.

12.4 Contractor shall verifiably oblige all persons who may get access to Confidential Information due to this contract to similarly comply with all confidentiality obligations imposed upon Contractor, also after they have ceased their activities for Contractor's business or after the contractual relationship between Principal and Contractor has ended.

12.5 Contractor may engage vicarious agents for the performance of the contract only with Principal's prior written consent. The above confidentiality obligations shall also verifiably be transferred to these vicarious agents by way of contract.

12.6 Contractor shall be liable for any damage if he fails to transfer and assign these confidentiality obligations.

12.7 At Principal's request, Contractor shall immediately return to Principal, destroy or permanently erase Confidential Information at any time, also after termination of the contract, including paper and electronic copies and any documents referring to Confidential Information. At Principal's request at any time, Contractor shall provide documentary evidence in a particular case that such information was erased or destroyed.

12.8 In case of an infringement of the confidentiality obligations, Principal may forthwith terminate the contract without notice or withdraw from the contract immediately.

12.9 Principal is not subject to a confidentiality obligation whenever Confidential Information must be transferred to insurance companies, experts or suppliers who were engaged by Principal and need to know that information due to their tasks, provided that they are not competitors of Contractor. If possible, Principal will pass on the obligation to keep that information confidential to these persons.

12.10 Contractor confirms that he is familiar and in compliance with the relevant applicable data protection provisions, including but not limited to the Albanian Law no. 124/2024 "On the Protection of Personal Data" (the "Data Protection Act") as well, to the applicable extent, the General Data Protection Regulation (the "GDPR"). Contractor guarantees to procure the security and therefore confidentiality, integrity and availability of personal data of the Principal which Contractor gets to know in the course of the contract according to Article 26 and Article 28 of the Data Protection Act, as well, to the applicable extent, Article 28 and Article 32 GDPR.

12.11 Contractor shall particularly not only adhere to special legal confidentiality obligations in the course of its processing operations, but also safeguard the confidentiality of data which Contractor gets to know subject to the terms of the contract. Furthermore,

reklamë në kantier, lejohen vetëm me pëlqimin e Porositësit.

12.3 Kontraktuesi do të marrë masat e duhura paraprake për të parandaluar çdo përdorim të paautorizuar të Informacionit Konfidencial dhe/ose për të shmangur çdo akses në Informacionin Konfidencial nga palë të treta.

12.4 Kontraktuesi do të marrë masa të verifikueshme për të detyruar të gjithë personat që mund të kenë akses në Informacionin Konfidencial për shkak të kësaj kontrate, që të respektojnë në mënyrë të ngjashme të gjitha detyrimet e konfidencialitetit të parashikuara për Kontraktuesin, edhe pasi ata të kenë ndërprerë aktivitetet e tyre për biznesin e Kontraktuesit ose pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore mes Porositësit dhe Kontraktuesit.

12.5 Kontraktuesi mund të angazhojë palë të treta për zbatimin e kontratës, vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të Porositësit. Detyrimet e mësipërme të konfidencialitetit do t'u transferohen gjithashtu në mënyrë të verifikueshme këtyre palëve të treta me kontratë.

12.6 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për çdo dëm nëse nuk arrin të transferojë dhe kalojë këto detyrime të ruajtjes së konfidencialitetit.

12.7 Me kërkesë të Porositësit, Kontraktuesi do t'i kthejë menjëherë Porositësit, do të shkatërrojë ose fshijë përgjithmonë Informacionin Konfidencial në çdo kohë, edhe pas përfundimit të kontratës, duke përfshirë kopjet në letër dhe ato elektronike dhe çdo dokument lidhur me Informacionin Konfidencial. Me kërkesë të Porositësit në çdo kohë, Kontraktuesi do të sigurojë prova dokumentare që për një rast të veçantë një informacion i tillë është fshirë ose shkatërruar.

12.8 Në rast të shkeljes së detyrimeve të konfidencialitetit, Porositësi mund ta zgjidhë kontratën menjëherë pa njoftim ose të tërhiqet menjëherë nga kontrata.

12.9 Porositësi nuk i nënshtrohet një detyrimi konfidencialiteti sa herë që Informacioni Konfidencial duhet t'i transferohet shoqërive të sigurimit, ekspertëve ose furnitorëve që janë angazhuar nga Porositësi, dhe të cilëve informacioni u duhet për shkak të detyrave të tyre, me kusht që ata të mos jenë konkurrentë të Kontraktuesit. Nëse është e mundur, Porositësi do t'i transferojë këtyre personave detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit.

12.10 Kontraktuesi konfirmon se ai njeh dhe zbaton parashikimet përkatëse ligjore për mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin Shqiptar nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ("Akti për Mbrojtjen e të Dhënave") si dhe, në masën e zbatueshme, Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave ("GDPR"). Kontraktuesi garanton të ruajë sigurinë dhe rrjedhimisht konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale të Porositësit, të cilat Kontraktuesi i merr gjatë zbatimit të kontratës, sipas nenit 26 dhe nenit 28 të Aktit për Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe, në masën e zbatueshme, Nenit 28 dhe Nenit 32 të GDPR.

12.11 Veçanërisht, Kontraktuesi jo vetëm që do të zbatojë detyrimet e posaçme ligjore të konfidencialitetit gjatë veprimtarisë së tij të përpunimit, por gjithashtu do të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të cilat ai i ka marrë në përputhje me kushtet e kontratës. Gjithashtu, Kontraktuesi

Contractor shall ensure that any person who may get to know data, is subject to a confidentiality obligation under this contract prior to commencing their activities. This confidentiality obligation survives also after these persons have ceased to carry out their activities and have left Contractor.

12.12 Contractor is liable vis-à-vis Principal for any property damage, financial loss and physical injuries caused by Contractor itself or by any action and omission of any of its employees or agents or by any other persons engaged by Contractor. Contractor is liable in particular for any disadvantage which Principal suffers due to a breach of any provision of this contract or of applicable data protection provisions.

12.13 These data protection obligations survive also after termination of the contract. In case of an infringement of the data protection obligations, Principal may forthwith terminate the contract without notice or withdraw from the contract immediately.

12.14 Whenever Principal instructs Contractor to process personal data as processor according to Article 5 (18) of the Data Protection Act, as well, to the applicable extent, Article 4 (8) GDPR, Contractor undertakes to conclude the processing agreement drafted by Principal according to Article 26 of the Data Protection Act, as well, to the applicable extent, Article 28 GDPR with Principal prior to concluding a contract. Furthermore, other additional statements shall be issued and documents and evidence provided according to Article 26 of the Data Protection Act, as well, to the applicable extent, Article 28 GDPR also directly to the Data Protection Officer (for example, if Principal itself acts as contractor).

13 Withdrawal

13.1 Principal may forthwith withdraw from the Purchase Order at any time in writing without stating any reason. In this case, Contractor is entitled to a compensation equal to the agreed (total) sum, while the following amounts are credited:

- savings in costs due to withdrawal,
- income earned or to be earned through any other use of Contractor's labor force or facilities and/or
- income earned through the sale of parts produced as well as finished and semi-finished products.

13.2 Principal's right to give extraordinary notice of withdrawal for good cause shall not be affected. Principal may forthwith withdraw from the Purchase Order for good cause.

13.3 Good cause is found to exist if Contractor's financial condition deteriorates or is at risk and the fulfillment of liabilities vis-à-vis Principal is therefore jeopardized, if the opening of insolvency proceedings with respect to Contractor's assets is dismissed for lack of assets to cover the costs or if these insolvency proceedings were cancelled due to a lack of assets to cover costs, if insolvency proceedings were opened with respect to Contractor's

do të garantojë që çdo person që mund të marrë dijeni mbi të dhënat, i nënshtrohet një detyrimi konfidencialiteti sipas kësaj kontrate përpara se të fillojë aktivitetet e tij. Ky detyrim konfidencialiteti mbetet në fuqi edhe pasi këta persona kanë pushuar së kryeri aktivitetet e tyre për Kontraktuesin.

12.12 Kontraktuesi është përgjegjëse ndaj Porositësit për çdo dëmtim të pronës, humbje financiare dhe dëmtim fizik të shkaktuar nga vetë Kontraktuesi ose nga çdo veprim ose mosveprim i ndonjë prej punonjësve ose agjentëve të tij ose nga çdo person tjetër i angazhuar nga Kontraktuesi. Kontraktuesi është veçanërisht përgjegjës për çdo disavantazh që pëson Porositësi për shkak të shkeljes së çdo dispozite të kësaj kontrate ose të dispozitave të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave.

12.13 Këto detyrime për mbrojtjen e të dhënave mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të kontratës. Në rast të shkeljes së detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave, Porositësi mund të zgjidhë menjëherë kontratën pa njoftim ose të tërhiqet nga kontrata në mënyrë të menjëhershme.

12.14 Sa herë që Porositësi udhëzon Kontraktuesin të përpunojë të dhëna personale si përpunues në përputhje me nenin 5 (18) të Aktit për Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe, në masën e zbatueshme, Nenin 4 (8) GDPR, Kontraktuesi merr përsipër të lidhë marrëveshjen e përpunimit të hartuar nga Porositësi në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe në masën e zbatueshme, nenin 28 të GDPR, përpara lidhjes së një kontrate. Për më tepër, deklarata të tjera shtesë dhe dokumente dhe prova sipas Nenit 26 të Aktit për Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe, në masën e zbatueshme, Nenin 28 GDPR, do t'i lëshohen apo jepen edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë Nëpunësit të Mbrojtjes së të Dhënave (për shembull, nëse vetë Porositësi vepron si kontraktor).

13 Tërheqja

13.1 Porositësi mund të tërhiqet në çdo kohë dhe në mënyrë të menjëhershme nga Urdhri i Blerjes, me shkrim dhe pa qenë e nevojshme të japë arsye. Në këtë rast, Kontraktuesi ka të drejtën e një shpërblimi të barabartë me shumën totale të rënë dakord, ndërsa shumat e mëposhtme kreditohen:

- kursimet në shpenzime për shkak të tërheqjes,
- të ardhurat e fituara ose që do të fitohen nëpërmjet çdo përdorimi tjetër të fuqisë punëtore ose objekteve të Kontraktuese, dhe/ose
- të ardhurat e fituara nga shitja e pjesëve të prodhuara si dhe e produkteve të përfunduara dhe gjysmë të përfunduara.

13.2 E drejta e Porositësit për t'u tërhequr në mënyrë të jashtëzakonshme nga Urdhri i Blerjes me shkak të justifikuar nuk cenohet. Porositësi mund të tërhiqet në mënyrë të menjëhershme nga Urdhri i Blerjes nëse ka shkak të justifikuar.

13.3 Konsiderohet se ekziston një shkak për t'u tërhequr nga kontrata nëse gjendja financiare e Kontraktuesit përkeqësohet ose është në rrezik dhe rrjedhimisht cenohet mundësia e përmbushjes së detyrimeve kundrejt Porositësit, nëse refuzohet hapja e procedurave të paafëtisë së paguese në lidhje me pasuritë e Kontraktuesit për mungesë pasurish për të mbuluar detyrimet, nëse procedurat e paafëtisë së paguese do të hapeshin lidhur me

assets and the legal provisions do not prohibit a withdrawal from the contract, if Contractor provides inaccurate information on material circumstances or does not fulfill or is unable to fulfill obligations under the Purchase Order. Contractor's services shall be settled as of the withdrawal date. In case of Principal's extraordinary withdrawal for good cause, Contractor shall not have any other claim for compensation. Contractor shall repay to Principal any overpayments immediately after the final invoice was issued.

13.4 Partial withdrawal is permissible.

13.5 Contractor may withdraw from the Purchase Order only for good cause as set out below:

- Without granting a grace period if the opening of insolvency proceedings against Principal's assets is denied for lack of assets or if such proceedings are cancelled on the grounds of lack of assets, or if insolvency proceedings were opened with respect to Principal's assets and withdrawal is not prohibited by legal provisions.
- Subject to granting two grace periods of at least 30 calendar days each, with each letter already having to include the notice of withdrawal, if Principal obstructs the proper provision of supplies/services by Contractor in a significant and sustainable manner or if Principal fails to pay to Contractor despite proper invoicing material claims, which are undisputed in terms of merit and amount and were already ordered in writing.

13.6 The grace period shall be set and notice of withdrawal given in writing. In this case, Contractor is entitled to a compensation for the supplies/services already provided.

14 Special terms for continuing obligations

14.1 Besides the other GTCP-AL provisions, the special terms referred to herein apply exclusively to continuing obligations such as framework agreements relating to maintenance, cleaning or equipment leases.

14.2 Principal may terminate the contract with 30 calendar day's notice without good cause. Principal may also terminate parts of supplies/services. Notice of termination shall be given in writing.

14.3 In this case, the final invoice is issued at the end of the notice period for the supplies/services provided until then according to the terms of the contract. Immediately after the final invoice was issued, Contractor shall repay to Principal any prepayments made for periods after the contract termination date.

14.4 Principal may terminate the Purchase Order at any time and with immediate effect for good cause, notwithstanding any other agreement. Principal's early termination may also refer to parts of a Purchase Order. Good cause for termination is found to exist, in particular, if Contractor's financial condition deteriorates or is at risk and the fulfilment by Contractor of liabilities vis-à-vis Principal is jeopardized, if the opening of insolvency proceedings with respect to Contractor's assets is denied on the grounds of lack of assets or if these insolvency proceedings are

pasuritë e Kontraktuesit dhe parashikimet ligjore nuk e ndalojnë tërheqjen nga kontrata, nëse Kontraktuesi jep informacion të pasaktë mbi rrethanat të rëndësishme ose nuk përmbush ose nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet sipas Urdhrit të Blerjes. Shërbimet e Kontraktuesit do të paguheshin në datën e tërheqjes. Në rast të tërheqjes së jashtëzakonshme të Porositësit me shkak, Kontraktuesi nuk do të ketë asnjë pretendim tjetër për shpërblim. Kontraktuesi do t'i kthejë Porositësit çdo pagesë të tepërt, menjëherë pas lëshimit të faturës përfundimtare.

13.4 Tërheqja e pjesshme lejohet.

13.5 Kontraktuesi mund të tërhiqet nga Urdhri i Blerjes vetëm me arsye, siç përcaktohet më poshtë:

- Pa zbatuar një afat shtesë të lejuar (*grace period*) nëse hapja e procedurave të paaftësisë paguese ndaj pasurive të Porositësit refuzohet për mungesë pasurish ose nëse këto procedura anulohen për shkak të mungesës së pasurive, ose nëse procedurat e paaftësisë paguese janë hapur në lidhje me pasuritë e Porositësit dhe tërheqja nuk ndalohet nga parashikimet ligjore.
- Duke zbatuar dy afate shtesë (*grace period*) prej të paktën 30 ditë kalendarike secila, me kusht që secila shkresë të përfshijë njoftimin e tërheqjes, nëse Porositësi pengon ofrimin e duhur të furnizimeve/shërbimeve nga Kontraktuesi, në mënyrë domethënëse dhe të qëndrueshme, ose nëse Porositësi nuk paguan Kontraktuesin, pavarësisht pretendimeve të bazuara në fatura të rregullta, të cilat nuk kundërshtohen në vlerë apo titull dhe janë urdhëruar me shkrim.

13.6 Periudha e afateve shtesë (*grace period*) do të caktohet me shkrim dhe njoftimi i tërheqjes do të jepet me shkrim. Në këtë rast, Kontraktuesi ka të drejtën e një shpërblimi për furnizimet/shërbimet e ofruara.

14 Afatet e posaçme për detyrimet në vazhdim

14.1 Përveç parashikimeve të tjera të GTCP-AL, afatet e posaçme të parashikuara këtu zbatohen ekskluzivisht për detyrimet e vazhdueshme, siç janë marrëveshjet kuadër në lidhje me mirëmbajtjen, pastrimin ose qiratë e pajisjeve.

14.2 Porositësi mund të zgjidhë kontratën duke dhënë njoftim paraprak prej 30 ditësh kalendarike, pa pasur nevojë të japë ndonjë arsye. Porositësi mund të përfundojë gjithashtu një pjesë të furnizimeve/shërbimeve. Njoftimi i zgjidhjes do të jepet me shkrim.

14.3 Në këtë rast, fatura përfundimtare lëshohet në fund të afatit të njoftimit për furnizimet/shërbimet e ofruara deri atëherë sipas kushteve të kontratës. Menjëherë pas lëshimit të faturës përfundimtare, Kontraktuesi do t'i kthejë Porositësit çdo parapagesë të bërë për periudha pas datës së zgjidhjes së kontratës.

14.4 Porositësi mund të zgjidhë Urdhrin e Blerjes në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm në rast se ka arsye, pavarësisht çdo marrëveshje tjetër. Zgjidhja paraprake e Porositësit mund të kryhet edhe për pjesë të një Urdhri Blerjeje. Konsiderohet se ekziston një arsye për zgjidhjen, në veçanti, nëse gjendja financiare e Kontraktuesit përkeqësohet ose është në rrezik dhe përmbushja e detyrimeve të Kontraktuesit kundrejt Porositësit rrezikohet, nëse hapja e procedurave të paaftësisë paguese në lidhje me pasuritë e Palës Kontraktuese refuzohet për shkak të

cancelled on the grounds of lack of assets, if insolvency proceedings were opened with respect to Contractor's assets and the termination of the contract is not prohibited by law, if Contractor provides incorrect information on material circumstances or does not or is unable to fulfill Contractor's obligations under the Purchase Order. In this case, the final invoice is issued on the effective termination date for services provided until then. Contractor shall repay to Principal any overpayments immediately after the final invoice was issued.

14.5 Contractor may terminate the Purchase Order only for good cause as follows:

- Without granting a grace period, if the opening of insolvency proceedings with respect to Principal's assets is denied for lack of assets or if such proceedings were cancelled on the grounds of lack of assets, or if insolvency proceedings were opened with respect to Principal's assets and the cancellation of the Purchase Order is not prohibited by legal provisions.
- Subject to granting two grace periods of at least 30 calendar days each, with each notice already having to include the termination statement, if Principal obstructs the proper provision of supplies/services by Contractor in a significant and sustainable manner or if Principal fails to pay to Contractor, despite proper invoicing, material claims, which are undisputed in terms of merit and amount and were already ordered in writing.

14.6 The grace period shall be set and notice of termination given in writing. In these cases, Contractor is entitled to a compensation for supplies/services already provided.

15 CE marks

In connection with the supply of machinery, partly completed machinery, components, systems, tools and processes that are subject to European directives or their national implementation, conformity (proof of conformity assessment procedure, CE marks) and compliance with any resulting additional requirements must be ensured. All resulting claims and measures are Contractor's responsibility and will not be separately compensated by Principal.

16 General provisions

16.1 The language of this Contract shall be English. The Albanian translation shall only be for the convenience of the Contractor. Any liability for the completeness and correctness of the Albanian translation shall be excluded. In case of any inconsistencies between the English original and the Albanian translation, the English original shall prevail.

16.2 Exclusive jurisdiction for disputes between the Principal and the Contractor lies with the Tirana Court of First Instance of General Jurisdiction, unless another court has mandatory jurisdiction under the law applicable to this contract *ratione materiae* and *ratione loci*. The contract shall exclusively be governed by and construed in accordance with Albanian law, to the extent allowed under the conflict of law rules of international private law and the UNCITRAL rules.

mungesës së pasurive ose nëse këto procedura të paaftësisë paguese anulohen për arsye të mungesës së pasurive dhe zgjidhja e kontratës nuk ndalohet me ligj, nëse Kontraktuesi jep informacion të pasaktë mbi rrethanat thelbësore ose nuk përmbush ose nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas Urdhrit të Blerjes. Në këtë rast, fatura përfundimtare lëshohet në datën e zgjidhjes për shërbimet e ofruara deri atëherë. Kontraktuesi do t'i kthejë Porositësit çdo pagesë të tepërt menjëherë pas lëshimit të faturës përfundimtare.

14.5 Kontraktuesi mund të zgjidhë Urdhrin e Blerjes vetëm me arsye si më poshtë:

- Pa zbatuar një afat shtesë të lejuar (*grace period*) nëse hapja e procedurave të paaftësisë paguese ndaj pasurive të Porositësit refuzohet për mungesë pasurish ose nëse këto procedura anulohen për shkak të mungesës së pasurive, ose nëse procedurat e paaftësisë paguese janë hapur në lidhje me pasuritë e Porositësit dhe anulimi i Urdhrit të Blerjes nuk përjashtohet nga parashikimet ligjore.
- Duke zbatuar dy afate shtesë (*grace period*) prej të paktën 30 ditë kalendarike secila, me kusht që secila shkresë të përfshijë njoftimin e zgjidhjes, nëse Porositësi pengon ofrimin e duhur të furnizimeve/shërbimeve nga Kontraktuesi, në mënyrë domethënëse dhe të qëndrueshme, ose nëse Porositësi nuk paguan Kontraktuesin, pavarësisht pretendimeve të bazuara në fatura të rregullta, të cilat nuk kundërshtohen në vlerë apo titull dhe janë urdhëruar me shkrim.

14.6 Periudha e afateve shtesë (*grace period*) do të caktohet me shkrim dhe njoftimi i zgjidhjes do të jepet me shkrim. Në këto raste, Kontraktuesi ka të drejtën e një shpërblymje për furnizimet/shërbimet e ofruara.

15 Markat CE

Në lidhje me furnizimin e makinerive, makineritë pjesërisht të përfunduara, komponentët, sistemet, mjetet dhe proceset që i nënshtrohen direktivave evropiane ose rregullave zbatuese të tyre në nivel kombëtar, duhet të sigurohet konformiteti (provë e procedurës së vlerësimit të konformitetit, shenjat CE) dhe përputhshmëria me çdo kërkesë shtesë. Të gjitha pretendimet dhe masat që rrjedhin nga sa më sipër janë përgjegjësi e Kontraktuesit dhe nuk do të kompensohen veçmas nga Porositësi.

16 Parashikime të përgjithshme

16.1 Gjuha e kësaj Kontrate do të jetë anglishtja. Përkthimi në shqip është kryer vetëm për lehtësinë e Kontraktuesit. Çdo përgjegjësi për plotësinë dhe korrektesinë e përkthimit në shqip do të përjashtohet. Në rast të ndonjë mospërputhje midis origjinalit në anglisht dhe përkthimit në shqip, origjinali në anglisht do të mbizotërojë.

16.2 Juridiksioni ekskluziv për mosmarrëveshjet ndërmjet Porositësit dhe Kontraktuesit i takon Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përveç rasteve kur një gjykatë tjetër ka juridiksion të detyrueshëm sipas ligjit të zbatueshëm për këtë kontratë *ratione materiae* dhe *ratione loci*. Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet ekskluzivisht në përputhje me ligjin shqiptar, në masën e lejuar sipas rregullave të konfliktit të ligjeve

16.3 Contracts and contract amendments shall be drawn up in writing. It is specifically agreed that Principal will also send electronically sealed SAP purchase order forms and SAP change order forms electronically (e.g. via e-mail) and that these documents are legally valid and binding. This form requirement may only be waived in writing. There are no oral side agreements.

16.4 The Parties to the Contract undertake to engage in fair business practices and reject any and all forms of corruption and bribery. Based on this understanding, the parties to the Contract agree to strictly comply with their respective internal compliance rules and procedures and with statutory anticorruption provisions. Thus, the parties to the Contract and their employees agree to neither offer, promise or grant nor to demand, make promise or accept any unjustified benefits of whatever kind in connection with the signing and performance of this Contract and the resulting contractual relationship. The Parties to the Contract also expect third parties involved in the performance of this Contract to act accordingly and undertake to urge them to comply with the law. The Parties to the Contract acknowledge that the Contract is performed exclusively in line with their regular business operations.

Pursuant to article 686 of the Albanian Civil Code, Contractor hereby declares to have read and understood these GTCP-AL, and to approve and accept all of its provisions as binding. The Contractor specifically accepts provisions under Sections 3, 7, 8, 9, 13, 14 and 16.

For acceptance by Contractor:

[Place] _____

[Date] _____

Signatures

[Contractor corporate name]

[Name of authorized representative]

sipas së drejtës ndërkombëtare private dhe rregullave të UNCITRAL-it.

16.3 Kontratat dhe ndryshimet e kontratës do të hartohen me shkrim. Është rënë dakord në mënyrë specifike që Porositësi do të dërgojë gjithashtu formularët e urdhrave të blerjes dhe formularët e ndryshimit të urdhrave, me vulë elektronike SAP me dhe në mënyrë elektronike (p.sh. përmes postës elektronike) dhe se këto dokumente janë ligjërish të vlefshme dhe detyruese. Nga kjo kërkesë forme mund të hiqet dorë vetëm me shkrim. Nuk lejohen marrëveshje të tjera me gojë.

16.4 Palët në Kontratë angazhohen në zhvillimin e praktikave të drejta të biznesit dhe të refuzojnë çdo formë të korrupsionit dhe ryshfetit. Bazuar në këtë mirëkuptim, palët bien dakord të respektojnë rreptësisht rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme përkatëse të pajtueshmërisë dhe parashikime dhe dispozitat ligjore kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë, palët si dhe punonjësit e tyre, bien dakord të mos ofrojnë, premtojnë ose të mos japin, dhe as të mos kërkojnë, premtojnë ose të mos pranojnë ndonjë përfitim të pajustificuar të çfarëdo lloji, i cili lidhet me nënshkrimin apo me zbatimin e kësaj Kontrate si dhe në lidhje me marrëdhënien kontraktore mes tyre. Palët kanë të njëjtat pritshmëri që edhe palët e treta të përfshira në zbatimin e kësaj Kontrate të veprojnë në përputhje me këtë frymë si dhe marrin përsipër t'i nxisin ata të respektojnë ligjin. Palët pranojnë se Kontrata është përmbytur tërësisht në përputhje me normat dhe me rregullta të tyre të operimit të biznesit.

Në bazë të nenit 686 të Kodit Civil Shqiptar, Kontraktuesi deklaron se i ka lexuar dhe kuptuar këto GTCP-AL, dhe se miraton dhe pranon të gjitha parashikimet e këtij dokumenti si detyruese. Kontraktuesi pranon në mënyrë specifike parashikimet sipas Seksioneve 3, 7, 8, 9, 13, 14 dhe 16.

Për pranim nga Kontraktuesi

[Vendi] _____

[Data] _____

Nënshkrimet

[Emri i shoqërisë së Kontraktuesit]

[Emri i përfaqësuesit të autorizuar]